



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:166385
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05875446

KPPP.nr.1189/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit NTP “Butterfly”, me NUI:811055658, me seli në Shtime, rr. “Industria” p.n., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata”, me adresë në rr.”B”, hyrja C/15, nr.3 Prishtinë, kundër debitorit N.P “Next Market” me NUI:810489949, me seli në Prishtinë, rr.”Vëllezërit Fazliu” nr.102, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit P.nr.32/2022 të datës 23.02.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli me seli të zyrës në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 25.06.2024, mori këtë:

AKTVENDIM

I.REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit N.P “Next Market”, ashtu që Urdhri P.nr.32/2022 i datës 23.02.2022, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrit P.nr.32/2022 të datës 23.02.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave dhe atë: faturës nr.1-2/2287005 e datës 13.07.2021, faturës nr.1-2/23022013 e datës 04.08.2021, faturës nr.1-2/2302012 e datës 04.08.2021, faturës nr.1-2/2302011 e datës

04.08.2021, faturës nr.1-2/2306019 e datës 10.08.2021, faturës nr.1-2/2311004 e datës 17.08.2021, faturës nr.1-2/2312010 e datës 18.08.2021, faturës nr.1-2/2312009 e datës 18.08.2021, faturës nr.1-2/2316015 e datës 24.08.2021, faturës nr.1-2/2317004 e datës 25.08.2021, faturës nr.1-2/2317003 e datës 25.08.2021, faturës nr.1-2/2321004 e datës 31.08.2021, faturës nr.1-2/2322021 e datës 01.09.2021, faturës nr.1-2/2322014 e datës 01.09.2021, faturës nr.1-2/2326004 e datës 07.09.2021, faturës nr.1-2/2327006 e datës 08.09.2021, faturës nr.1-2/2327005 e datës 08.09.2021, duke urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të urdhrit, t'ia paguajë kreditorit borxhit 2.029.40 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbimore sipas tarifës së përmbaruesve, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përmbaruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se kreditori nuk ja ka bashkangjitur dokumentet përkatësisht faturat burimore në origjinal, ose kopje të noterizuara. Më tej ka theksuar se kreditori dhe debitori marrëdhëniet e tyre i kanë të rregulluara me kontratën nr.29/2021 të datës 09.02.2021, për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2021, në bazë të kontratës të lartëcituar përcaktohet edhe bonusi në lartësi prej 3% të vlerës së përfshirë në faturë (neni 6 i kontratës), gjithashtu me kontratë përcaktohet se mosmarrëveshjet eventuale duhet të zgjidhen me mirëkuptim përmes bisedimeve (neni 7 i kontratës), kreditori i ka shkel në mënyrë të njëanshme të dy nenet e kontratës në fuqi. Debitori i ka propozuar gjykatës që të aprovoj në tërësi si të bazuar Prapësimin e debitorit dhe të anuloj në tërësi Urdhrin Përmbarimor P.nr.32/2022.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se faturat mbi bazën e të cilave është parashtruar propozimi për përmbarim janë origjinale. Po ashtu neni 6 i kontratës të cilës i referohet debitori përcakton bonusin vjetor në bazë të qarkullimit të mallit në lartësi prej 3%, që nënkupton se pas kalkulimit të qarkullimit vjetor të mallit (gjatë vitit 2021) realizohet bonusi prej 3%, mirëpo kjo nuk nënkupton se pas çdo dërgese të mallit do të realizohet bonusi 3%, andaj konsiderojmë se kreditori i është përmbajtur kontratës se lidhur me debitorin, tutje kreditori konsideron se debitori disa herë është ftuar që t'i përmbushë detyrimet e tij sipas faturave të bashkangjitura propozimit për përmbarim, mirëpo meqenëse debitori nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të përmbushjes së detyrimit zgjidhja e vetme ka mbet realizimi i të drejtës në kompensim për shërbimet e ofruara përmes procedurës përmbimore. Kreditori ka kërkuar nga Gjykata që të

refuzoj si të pa bazuar prapësimin e debitorit, të vërtetoj Urdhrin Përmbartimor P.nr.32/2022 dhe të detyroj debitorin që t'ia kompensoj kreditorit të gjitha shpenzimet procedurale.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim dokumentet e besueshme: faturës nr.1-2/2287005 e datës 13.07.2021, faturës nr.1-2/23022013 e datës 04.08.2021, faturës nr.1-2/2302012 e datës 04.08.2021, faturës nr.1-2/2302011 e datës 04.08.2021, faturës nr.1-2/2306019 e datës 10.08.2021, faturës nr.1-2/2311004 e datës 17.08.2021, faturës nr.1-2/2312010 e datës 18.08.2021, faturës nr.1-2/2312009 e datës 18.08.2021, faturës nr.1-2/2316015 e datës 24.08.2021, faturës nr.1-2/2317004 e datës 25.08.2021, faturës nr.1-2/2317003 e datës 25.08.2021, faturës nr.1-2/2321004 e datës 31.08.2021, faturës nr.1-2/2322021 e datës 01.09.2021, faturës nr.1-2/2322014 e datës 01.09.2021, faturës nr.1-2/2326004 e datës 07.09.2021, faturës nr.1-2/2327006 e datës 08.09.2021, faturës nr.1-2/2327005 e datës 08.09.2021, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në

këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet nga vula e pranimi të debitorit në këto fatura.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1189/23, me datë 25.06.2024

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.